

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“NOVA TRAVEL & TOURS” shpk**

Sot, më 03.04.2024, ne, themeluesit,

- a) **Ervin Shyti**, atësia Bari, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BB9441013, me numër personal identifikimi K00522009A, i datëlindjes 22.05.2000, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- b) **Xhoana Shyti**, atësia Sahit, shtetase shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BC6713910, me numër personal identifikimi J65701087C, e datëlindjes 01.07.1996, lindur në Koçaj dhe banues në Tiranë; madhere me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “NOVA TRAVEL & TOURS” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a. Ndërmjetës, agjensi udhëtimesh dhe/ose operator udhëtimesh;
- b. Organizimin e udhëtimeve individuale dhe/ose kolektive për shtetas vendas dhe/ose të huaj, brenda dhe jashtë vendit ose ndërmjetësimin për shitjen e produkteve të këtij aktiviteti;
- c. Shitje biletash transporti detar, ajror, tokësor;
- d. Organizim transporti turistik tokësor, me ose pa guidë shoqëruese;
- e. Rezervimin e apartamenteve dhe hoteleve, tureve, biletave të hyrjes në muze, parqe lojrash, evenete të ndryshme sportive, kulturore dhe artistike;
- f. Trajnime, konferanca, seminare, kurse të ndryshme dhe kualifikime në fushën e turizmit;
- g. Organizimin e eveneve në fushën e turizmit dhe përvitjes së turistëve të ndryshëm; organizim i seminareve trajnuese dhe informuese për guida dhe/ose operatorë të ndryshëm turistikë të huaj ose shqiptarë, si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me këtë objekt, sipas legjislacionit në fuqi;
- h. Ndërtim,blerje, qeradhënie/qeramarrje, përdorim dhe/ose menaxhim i hoteleve;
- i. Shërbimet e lidhura me pritjen turistike si shërbimi i guidë-përkthyesve, shoqëruesve;



*Faqe 1 e 3  
Akti i Themelimit  
shpk*



- j. Aktiviteti i asistencës teknike dhe tregtare në sektorin turistik;
- k. Ofrimin e makinave me qera dhe ambiente akomodimi me qera ditore;
- l. Blerje ose qiradhënie e zyrave dhe/ose apartamenteve për ushtrimin e aktivitetit;
- m. Menaxhim i zyrave të udhëtimit për palët e treta;
- n. Blerja ose marrja me qera e mjeteve ajrore për kryerjen e udhëtimeve turistike;
- o. Projektim, zbatim, përshtatje, menaxhim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës dhe shërbimeve për turizmin;
- p. Hartim, zbatim dhe menaxhim i projekteve të lidhura me turizmin;
- q. Reklama/promocion në çfardo instrumenti dhe forme, që kanë lidhje me turizmin;
- r. Shitje online;
- s. Siguracion shëndeti dhe makinash;
- t. Promovimin e turizmit vendas e te huaj;
- u. Bashkëpunimin me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh, persona juridike, fizike, individe, institucionale te ndryshme shteterore publike/private etj, vendase dhe/ose të huaja, hotele, resorte, restorante etj, që kanë objekt veprimtarie të njejte me shoqërinë apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë;
- v. Pjesëmarrjen në procedura prokurimi publik të organizuara nga institucionet shtetërore;

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në pasurinë e paluajtshme me Nr. 8/217-N7 e ndodhur në Zonën Kadastrale 8330 Vol.16 Faqe 210, Tiranë, në adresën rruga “Jordan Misja”.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues Ervin Shyti, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues Xhoana Shyti, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

*Faqe 2 e 3  
Akti i Themelimit  
shpk*

**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Xhoana Shyti, atësia Sahit, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të pasaportës me numër BC6713910, me numër personal identifikimi J65701087C, e datëlindjes 01/07/1996, lindur në Koçaj dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K Ë T**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"NOVA TRAVEL & TOURS" shpk**

**Ervin Shyti**



**Xhoana Shyti**

